

**Plani vjetor
për parandalimin e korrupsionit në Agjencinë e Emigracionit për vitin 2023**

Shkup, dhjetor 2022

1. Analiza e fushave të rrezikshme të korrupsionit brenda fushëveprimit

Agjencia e Emigracionit i kryen punët që kanë të bëjnë me pozitën dhe të drejtat e mërgimtarëve; ndihmën në zhvillimin e tyre kulturor dhe përmirësimin e lidhjeve me ta dhe organizatat e tyre; informimin e mërgimtarëve për situatën në Republikën e Maqedonisë së Veriut; krijimin e kushteve për kthimin e mërgimtarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut; krijimin e kushteve për përfshirjen e mërgimtarëve në jetën publike dhe ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjatë punës së saj të rregullt, Agjencia e Emigracionit rregullisht i analizon dhe merr parasysh fushat e rrezikut në kornizë të fushëveprimit të saj dhe kompetencat e saj.

Lidhur me korrupsionin, duke marrë parasysh buxhetin vjetor në dispozicion të Agjencisë së Emigracionit, dhe aktivitetet e parapara në Programin e Punës 2023, fushat e rrezikshme të korrupsionit brenda të cilave rregullisht merren masa për zvogëlimin dhe eliminimin e rrezikut, janë prokurimet publike dhe punësimet.

Deri tani, Agjencia e Emigracionit nuk është përballur me probleme lidhur me korrupsionin, kështu që mund të konstatohet lirshëm se rreziku i paraqitjes së korrupsionit është minimizuar. Megjithatë, rreziku i paraqitjes së korrupsionit dhe konfliktit të interesit, si një mundësi duhet të analizohet me qëllim që të vazhdojë puna ligjore, cilësore, e përgjegjshme dhe efikase, që gjithashtu nënkupton luftën kundër korrupsionit të mundshëm.

Faktori, si buxheti relativisht i vogël, që është planifikuar dhe zbatuar ekonomikisht, duke përfshirë buxhetin e synuar për procedurat e prokurimit publik me vlerë të ulët, ndërgjegjësimi i lartë i punonjësve për punë të ndërgjegjshme, dhe integriteti i tyre çojnë në minimizimin e rrezikut të korrupsionit.

Arsyet që mund të çojnë në korrupsion janë arritja e përfitimit material apo përfitimit tjetër, apo shpërdorimit të detyrës, autoritetit publik, pozitës zyrtare të funksionarëve apo punonjësve, janë kur zbatohen procedurat e prokurimit publik, apo procedurat e punësimit.

2. Respektimi i rregullave ligjore, Kodi i Sjelljes Etike të anëtarëve të Qeverisë, dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria dhe Kodi i Nëpunësve Administrativë

Agjencia e Emigracionit, ka vendosur rend dhe praktikë të respektimit të rregullave ligjore nga ana e funksionarëve të emëruar dhe nëpunësve administrativ. Po ashtu respektohet edhe Kodi i Sjelljes Etike të anëtarëve të Qeverisë, dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria, si dhe Kodi i Nëpunësve Administrativë.

Gjatë punësimit të nëpunësve administrativ të sapo pranuar, u jepet Kodi i Nëpunësve Administrativë, ndërsa të gjithë nëpunësit udhëheqës kalojnë provimin e menaxhimit administrativ, ku janë përfshirë edhe sferat e Kodit të Nëpunësve Administrativë, profesionalizmi dhe etika e nëpunësve administrativ.

3. Transparenca dhe llogaridhënia e punës në Agjencinë e Emigracionit

Puna në Agjencinë e Emigracionit është transparente dhe të gjitha aktivitetet e ndërmarra dhe të zbatuara vendosen në faqen e internetit të Agjencisë.

Përveç kësaj, edhe të dhënat e mëposhtme janë siguruar në faqen e internetit:

- Buxheti i Agjencisë së Emigracionit,
- Llogaria vjetore e buxhetit,
- Plani i prokurimit publik,
- Plani strategjik i Agjencisë,
- Plani vjetor i punës së Agjencisë,

- Shpalljet vijuese,
- Kontakti me person të autorizuar për pranim të denoncimeve të dorëzuara për raportim të brendshëm dhe të jashtëm të mbrojtur, në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së Denoncuesve.
- Kontakti i një personi të autorizuar për qasje të lirë në informacione me karakter publik

4. Identifikimi i shkaqeve dhe faktorëve që mundësojnë korrupsionin

Arsyet që mund të çojnë në korrupsion, janë në fakt realizimi i përfitimit material apo përfitime të tjera dhe shpërdorimi i funksionit, autorizimit publik, pozitës zyrtare të një ose më shumë punonjësve, kur zbatohen procedurat e prokurimit publik, të punësimit, apo procedura tjera.

Agjencia e Emigracionit ka faktorë që e reduktojnë, ose e minimizojnë rrezikun e korrupsionit në nivelin më të ulët, të tillë si buxheti relativisht i vogël, që është planifikuar dhe zbatuar ekonomikisht duke përfshirë buxhetin e caktuar për procedurat e prokurimit publik, që janë me vlerë më të ulët. Gjithashtu ekziston vetëdije të lartë për punën e ndërgjegjshme dhe ligjore ndërmjet punonjësve të Agjencisë.

Përveç kësaj, Agjencia ka futur disa mekanizma kontrolli, dhe mjete për të eliminuar rrezikun e korrupsionit dhe konfliktin e interesave.

5. Mjetet dhe mekanizmat e kontrollit për të kapërcyer zonat e zbuluara të rrezikut

Në procedurat e prokurimit publik dhe të punësimit, me qëllim të eliminimit të mundësive të abuzimit të tyre, Agjencia e Emigracionit ka vendosur mjete dhe mekanizma të duhur të kontrollit.

Agjencia e Emigracionit, ka përgatitur një procedurë të brendshme të zbatimit të prokurimit publik në Agjencinë e Emigracionit, të evidentuar sipas numrit 03/113 më 09.02.2023.

Kjo procedurë rregullon tërësisht përgatitjen e prokurimit publik, zbatimin e prokurimit publik, lidhjen e kontratave të prokurimit publik dhe zbatimin e tyre.

Fillimisht, Agjencia e Emigracionit në mënyrë transparente, dhe bazuar në burimet e planifikuara të financimit në buxhet, miraton Planin vjetor të prokurimit publik,

të cilin e publikon në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik-SEPP, dhe në internet faqen e Agjencisë.

Të gjitha procedurat e prokurimit publik përmbajnë mekanizma kontrolli në zbatimin e të gjitha veprimtarive lidhur me prokurimet.

Procedura e prokurimit publik në Agjenci, si mekanizëm kontrollues përmban deklaratën e moskzistencës së konfliktit të interesit, e cila nënshkruhet nga personi përgjegjës i Agjencisë, kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit të prokurimit publik, të gjithë anëtarët dhe zëvendësit e anëtarëve në ditën e hapjes publike të ofertave.

Gjithashtu, Agjencia vepron në pajtim me Procedurën e Punësimit të Nëpunësve Administrativ në Agjenci, ku gjatë zbatimit të procedurave, të gjithë anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, nënshkruajnë deklarata për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale.

Në periudhën e ardhshme Agjencia do të ndjekë edhe zgjidhjet e reja ligjore në fushën e korrupsionit, dhe do të veprojë ndaj të njëjtave.

6. Aktivitetet e planifikuara për parandalimin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave në Agjencinë e Emigracionit

Për të parandaluar korrupsionin dhe konfliktin e interesave, Agjencia e Emigracionit do t'i ndërmarrë këto aktivitete:

- Ndjekja e vazhdueshme e zgjidhjeve ligjore në fushën e korrupsionit, dhe zbatimi i tyre në përputhje me situatat e reja në identifikimin e rreziqeve të paraqitjes së korrupsionit.
- Do të shqyrtojë menjëherë të gjitha rastet e dyshuara të korrupsionit dhe konfliktit të interesit apo korrupsionit të krijuar real, me qëllim përmirësimin e sistemit të kontroleve të brendshme,
- Do të zbatojë si deri tani, një politikë të tolerancës zero të korrupsionit dhe konfliktit të interesit, dhe do të vendosë një sistem të fortë kontrolli në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit, konfliktit të interesit, si dhe për uljen e efektit të tyre, nëse ato ndodhin,
- Punonjësve të Agjencisë do t'u sigurohet trajnim për mënyrën e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave të paktën një herë në dy vjet.

Slobodan Bliznakovski,
drejtor
Përpunoi: Violeta Sekulova